

Република Македонија
Општина Желино
п.п. Желино - 1226
Тел: 044 /378-030 факс.378-040



Republika e Maqedonisë
Komuna e Zhelinës
p.f. Zhelinë - 1226
tel: 044/378-030 fax.378-040

**LLOGARIA PËRFUNDIMTARE
E BUXHETIT TË KOMUNËS SË ZHELINËS
PËR VITIN 2014**

Zhelinë, Mars 2015

Në bazë të nenit 36 alineja 1 pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/2002) dhe nenit 33 pika 1 i Ligjit për financimin e njësive të vetë administrimit lokal ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 61/04, 22/07, 67/07, 156/09 dhe 47/11), Këshilli i Komunës së Zhelinës në seancën 21 të mbajtur më 13.03. 2015 vj., solli:

LLOGARINË PËRFUNDIMTARE TË BUXHETIT TË KOMUNËS SË ZHELINËS PËR VITIN 2014

PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Komunës së Zhelinës për vitin 2014 përbëhet nga:

	Buxheti	Llogaria Përfundimtare
I. TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	367.184.000	234.750.271
Të ardhura tatimore	49.860.000	23.635.608
Të ardhura jo tatimore	1.200.000	566.219
Të ardhura kapitale	119.944.000	46.469.148
Të ardhura nga dotacionet	131.800.000	131.584.000
Transfere	62.980.000	31.095.296
Të ardhura nga donacionet	1.400.000	1.400.000
II. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	369.794.000	232.013.552
Destinime të përcaktuara	368.794.000	232.013.552
Rezerva	1.000.000	0
III. DEFICIT	-2.610.000	2.736.719
IV. FINANCIM	-1.000.000	0
Prurje	0	0
Prurje nga vendi	0	0
Prurje nga huazime jashtë vendit	0	0
Depozite	0	0
Derdhje	1.000.000	
Pagesa e kryegjësë	1.000.000	0

Neni 2

Saldo nga të gjitha llogaritë e Buxhetit të Komunës së Zhelinës më datë 31.12.2013 është **3.902.756,00** denarë dhe atë:

Saldo e buxhetit themelorë	2.402.662,00 den.
Saldo e buxhetit të dotacioneve me dedikim	1.463.418,00 den.
Saldo e buxhetit të aktiviteteve vetë financuese	36.676,00 den.

Saldo e buxhetit themelorë në shumë prej **2.402.662,00** den. do të bartet si prurje në buxhetin themelor të Komunës së Zhelinës për vitin 2015.

Saldo e buxhetit të dotacioneve në shumë prej **1.463.418,00** den. do të bartet si prurje në buxhetin e dotacioneve të dedikuara të Komunës së Zhelinës për vitin 2015.

Saldo e buxhetit të aktiviteteve vetë financuese në shumë prej **36.676,00** den. do të bartet si prurje në buxhetin e aktiviteteve vetë financuese të Komunës së Zhelinës për vitin 2015 (llogarina e SHF "Pashko Vasa" f. Grupçin **34.993,00 den** dhe SH.F.Luigj Gurakuqi f.Zhelina **1.683,00 den**)

Neni 3

Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara sipas burimeve dhe llojeve, përkatësisht shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara sipas destinimeve themelore janë të paraqitura në bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve:

Neni 4

Në pjesën e Veçantë të Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Zhelinës për vitin 2014 janë të paraqitura shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara sipas nën programeve, llogarive dhe destinimeve themelore.

Neni 5

Pjesa e përgjithshme e Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Zhelinës për vitin 2014 do të shpallet në Gazetën zyrtare të Komunës së Zhelinës.

Nr. 08- 362/3
20.03.2015 vj.

Këshilli i Komunës së Zhelinës

Kryetari

Arijeta Rexhepi

